

UDHËZIM
Nr. 20, datë 2.10.2024

**PËR NDRYSHIMET NË UDHËZIMIN NR. 12, DATË 30.6.2023, TË MINISTRIT TË
ARSIMIT DHE SPORTIT, “PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË
REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të urdhrit nr. 113, datë 26.3.2024, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 12, datë 30.6.2023, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Pika 9, e kreut VII, ndryshohet si më poshtë:

“9. Për ndjekjen e studimeve në programe të ciklit të dytë, pranohen kandidatët që:”;

b) Në pikën 9, të kreut VII, shkronjat “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) zotërojnë një diplomë të ciklit të parë, të fituar pas përfundimit me sukses të studimeve përkatëse në një institucion të arsimit të lartë dhe program studimi, i cili ka qenë i licencuar përpara regjistrimit të studentit dhe me akreditim përpara lëshimit të diplomës, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi të kohës.

Për kandidatët të cilët zotërojnë diplomë të ciklit të parë të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë të mbyllura në zbatim të legjislacionit në fuqi, data e lëshimit të diplomës duhet të ketë qenë sipas afateve të përcaktuara në aktet nënligjore për mbylljen e tyre. Vërtetësia (autenticiteti) i të dhënave të këtyre diplomave konfirmohet përmes vërtetimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

Vlerësimi i mësipërm kryhet nga institucioni përgjegjës për dhënien e numrave të matrikullimit, i cili sipas rastit, kërkon informacion në MAS dhe ASCAL, lidhur me aktet e licencimit dhe akreditimit të institucioneve dhe/ose të programeve të studimit.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimit Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Ana Kapaj